



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.32/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Arsim Hamzaj kryesues, Skender Çoçaj dhe Kymete Kicaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e e Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të thyerjes së Kodit të Mirësjelljes, për Zgjedhjet e Përgjithshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës që do të mbahen me datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur me datë 15.01.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Pranohet e bazuar ankesa Anr.32/2025 e datës 14.01.2025, e paraqitur nga subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë,

II. Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), i shqiptohet dënimi më gjobë në lartësi prej 2,000.00 (dy mijë) euro, për shkak të shkeljes së Kodit në fushatë zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Kosovës, që do të mbahen me datë 09.02.2025.

III. I NDALOHET Berat Gashi, Anëtar i KKZ-së, nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), në Komunën e Obiliqit, pjesëmarrja në zgjedhje, si kandidat apo edhe si pjesë administrative e ndonjë organi zgjedhor për periudhën kohore, në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite, nga dita e marrjes së vendimit, duke përfshirë edhe Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Kosovës, që do të mbahen me datë 09.02.2025.

IV. Detyrohet Subjekti Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, që gjobën e shqiptuar si në pikën -I-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi, nën kërcënim e shqiptimit të dënimit shtesë.

A r s y e t i m

Me datën 14.01.2025 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike (LDK), dega në Obiliq, në të cilën pretendohet se Berat Gashi në pozitën e Anëtarit të

Komisionit Zgjedhor (KKZ), ka marrur pjesë në tubime zgjedhore të organizuar nga Subjekti Politik LVV, edhe pse ky veprim është i ndaluar dhe se veprimi i tillë shihet edhe nga fotoja.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur si provë fotografi nga tubimi i mbajtur.

Më datë 14.01.2025, PZAP-i, e njoftoi Subjektin Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), për ankesën e paraqitur kundër tyre, duke i dërguar kërkesë për përgjigje deri me datë 15.01.2025 në ora 12:00. Në përgjigjen e subjektit politik LVV, është theksuar se kanë praktikuar trajnime për anëtarët e tyre të cilët janë pjesë e komisioneve zgjedhore, për më tepër të gjithë aktivistëve përfshirë anëtarët e KKZ nga radhët e LVV –së, iu kanë shpjeguar rregullat zgjedhore dhe legjislacionin përkatës, lidhur me fushatën dhe ditën e votimit sipas nenit 33 të LZP-së.

Në përgjigje në ankesë thuhet se për kundër kësaj për shkak të volumit të madh të punës gjatë fushatës, ka rastisur që anëtari Berat Gashi, të jetë prezent në këtë takim, veprim i cili mund të konsiderohet si pakujdesi e personit në fjalë, duke marr parasysh natyrën e fushatës.

Mëtutje në përgjigjen e LVV-së, theksohet se ka marrur masa përmirësuese dhe ka bërë fshirjen e fotos dhe postimin në rrjetin social facebook, dhe se e njëjta nuk gjendet më në llogarinë e rrjetit social përkatës.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesën gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Paneli, gjatë shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe pas shikimit të bërë fotografisë së ofruar si provë materiale e cila është publikuar në rrjetin social nga ana e kandidatit për deputet të Subjektit Politik LVV, Halil Thaci, shihet qartë se në tubimin zgjedhor të subjektit politik LVV ka marrë pjesë anëtari i KKZ-së, së këtij subjekti, në Komunën e Obiliqit, Berat Gashi.

Paneli, për të vendosur dhe pranuar një ankesë si të bazuar vendimin e tij e mbështet në dëshmi të qarta dhe bindëse siç përcaktohet me Rregullen Zgjedhore Nr.02/2024, Emërimi dhe Funksonimi i Komisioneve Komunale përkatësisht neni 6 paragrafi 3, Anëtarit të KKZ-së i revokohet emërimi me Vendim të KQZ-së, përkatësisht neni 3.4.” merr pjesë në një fushatë zgjedhore në emër të një subjekti politik, ose ndërhyr në procesin zgjedhor”.

Paneli me rastin e vendosjes si në pikën -III-, të dispozitivit të këtij vendimi, është vendosur duke u bazuar në dispozitën ligjore të nenit 120 të LZP-së, përkatësisht paragrafi 3.4 në të cilin parashihet se: “Në rast se ka ndodhur një shkelje e këtij ligji ose rregullave zgjedhore e cila e minon integritetin e zgjedhjeve PZAP-ja mund të: Ndalojë një individ të marr pjesë në zgjedhjet e mbajtura nën autoritetin e KQZ-së, si kandidat apo edhe si pjesë administrative e ndonjë organi zgjedhor, për një periudhë kohore që nuk i kalon gjashtë (6) vite”.

Paneli ka gjetur se anëtari i KKZ-së, Berat Gashi, nga subjekti politik LVV, ka marrur pjesë në tubimet zgjedhore e që kandidati për deputet të njëjtit subjekt politik, Halil Thaci e ka publikuar llogarinë e tij në rrjetin sociale facebook, e për më tepër veprimet e tilla rezultojnë se janë në kundërshtim edhe me kodin e sjelljes për anëtarë të KKZ-së.

Paneli, konform nenit 13 par. 6 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr. 01/2024, me datë 14.01.2025, ndërmori hetim lidhur me pretendimet e paraqitësit të ankesës dhe gjeti se të njëjtat janë të bazuara.

Nga fotografitë të cilat gjenden në shkresat e lëndës, gjatë hetimit të ndërmarrë nga PZAP-i, si dhe nga përgjigjja e Subjektit politik LVV, është vërtetuar se është realizuar një tubim elektorale nga ana e kandidatit për deputet të Subjektit Politik LVV, Halil Thaci, në të cilin tubim shihet qartë se pjesëmarrës ka qenë edhe Berat Gashi, i cili rezulton që të jetë Anëtarë i Komisionit Komunal Zgjedhor (KKZ,) në komunën e Obiliqit.

Referuar, Kodit të sjelljes për anëtarë të Komisionit Komunal të Zgjedhjeve (KKZ) për Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës, që do të mbahen më 9 shkurt 2025 parasheh që nëse anëtari nuk i kryen detyrat e tij sipas rregulloreve të KQZ-së, vepron në mënyrë të njëanshme dhe joprofesionale, nuk merre pjesë në dy takimet e njëpasnjëshme të KKZ-së, pa ndonjë arsye të bazuar, i cili merr pjesë në një fushatë zgjedhore në emër të një subjekti politik ose ndërhyr në procesin zgjedhor, do të i ndërpritet emërimi si anëtar i KKZ-së.

Në rastin konkret paneli ka vërtetuar se anëtari i KKZ-së, Berat Gashi në Komunën e Obiliqit, ka bërë shkelje të dispozitave të lartcekura sepse ka vepruar në mënyrë jo profesionale duke marrë pjesë në një tubim elektorale të organizuar nga subjekti politik LVV.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: *“vendosja për ankesat nga PZAP-ja, mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”*, Paneli, me rastin e vendosjes se gjohës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, pjesëmarrja e subjektit në fjalë në zgjedhjet e mëparshme që konsiston në faktin se Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës zgjedhore.

Përveç të cekurave më lartë Paneli, me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), në kuadër të pretendimeve të theksuara në përgjigje në ankesë, dhe se i njëjti e ka pranuar shkeljen e pretenduar dhe si të tilla ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka Paneli, vlerësoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashpresa
Anr.32/2025 më datën 15.01.2025

Kryesues i Panelit
Arsim Hamzaj



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.